

Të fillojnë të shohin ato që duhet të shohin

Autor: Zoran Jovanoski

Çdo mëngjes të ri në Tetovë, në ora shtatë, Beni Sherifi dhe djali i tij 11 vjeçar, Aldini, fillojnë edhe një ditë të re të gjatë duke u nisur për në shkollë.

“Në mëngjes kur zgjohem, i laj dhëmbët, vishem, e marr çantën dhe dal nga shtëpia”, tregon Aldini.

Rrugës ndalen për ta marr edhe shoqen e tij të klasës Lile. Aldini është i vogël me shikim të dëmtuar. Duhet të udhëtojë deri në Shkup, sepse në Tetovë nuk ka shkollë për fëmijët si ai.

“Unë nuk punoj. Tërë ditën ia kushtoj Aldinit. Bashkëshortja ime punon privatisht. Kështu gjindemi”, thotë babai i tij Beni.

“Hyri në makinë, dhe shkojmë në Shkup, por deri në Shkup më vjen vështirë. Rruga deri aty është shumë e gjatë”, ankohet Aldini.

Pas një orë udhëtimi arritën në kohë në shkollën e vetme për rehabilitim për fëmijë dhe të rinj me shikim të dëmtuar në vend. Në shkollën mësojnë afër 50 nxënës. Disa prej tyre, edhe pse janë të vegjël, jetojnë në konvikt, sepse vijnë nga vende që janë larg Shkupit, ndërsa disa udhëtojnë, sikur Aldini.

Ai kishte test në lëndën e matematikës. Nuk e preferon shumë atë aktivitet, por patjetër ishte ta bën. Detyrat i zgjodhi duke përdorur mjete ndihmëse të posaçme. Deri më tani ka ushtruar mjaft dhe shpejt e morri rezultatin.

“Më pëlqen vizatimi sepse ora është më e shkurtër, ndërsa matematika nuk më pëlqen. Për matematikë shumë duhet të mbash në mend dhe të përdorësh trurin”, konstaton Aldini.

Babai i tij, kështu e përshkruan djalin e tij: “Aldini si fëmijë është shumë inteligjent. Mëson gjuhë, ato i ka të rëndësishme, posaçërisht gjuhën angleze. Është shumë komunikativ. Me të gjithë mund të adaptohet. Ka shokë, shoqe, si në Shkup, ashtu edhe në Tetovë. Njerëzit e duan shumë. Është i tillë”.

Fëmijët e verbër në vend, mësojnë nga numrat e njëjtë nga librat pothuajse 16 vite, edhe pse programi shpesh është ndryshuar. Mësonjëtoret janë shumë të ndryshme nga ato normalet. Gjithçka është e përshtatur për nevojat e tyre për lëvizje, orientim, mësim...

“Mund të lavdërohem me ndërtesën e re të shkollës e cila, më besoni, është objekt i cili i përmbush të gjitha nevojat për nxënës të kësaj kategorie”, theksoi drejtori i shkollës “Dimitar Vllahov”, Goranço Jakimov.

Edhe pse kjo është shkolla e vetme shtetërore për fëmijë dhe të rinj me shikim të dëmtuar në vend, kishte nevojë për donacione nga jashtë që të përmirësohet procesi arsimor. Në fakt, ashtu është ndërtuar dhe pajisur edhe ky objekt i ri ku mëson Aldini i vogël.

Zharko Sellkoski është kryetar i Lidhjes kombëtare të verbërve. Në të ka afër 2500 anëtarë. Ai thotë se është i bindur se numri i të verbërve në vend është më i madh. Nuk dihet as sa fëmijë të verbër ka. Zyrtarisht në mësim janë regjistruar vetëm ato 50 nxënës që mësojnë në Shkup.

“Numri i fëmijëve të cilët nuk shkojnë në shkollë me siguri është shumë i madh. Ato që nuk mund të udhëtojnë deri në Shkup duhet të jenë të përfshirë në shkollat e rregulltë, por aty nuk ka kushte përkatëse për to. Kërkojmë nga institucionet që ta mundësojnë atë”, tha Sellkoski.

Kur institucionet përkatëse nuk bëjnë shumë, individët e mbushin zbrazëtirën. Një prej tyre është Gazmend Azemi. Ai është i verbër dhe është absolvent në studimet për shkenca kompjuterike. Ai krijon aplikim kompjuterik me opsion për zë që me ndihmë të saj nxënësit e verbër të mund të ushtrojnë për testimin ekstern. Që të mund ta krijojë programin, i nevojitet data baza me pyetjet nga Ministria e arsimit.

“Pikërisht mungesa e literaturës dhe qasjes deri në burimet më ndihmoi të vij deri në këtë ide. Kjo faktikisht është lojë me të cilën dëshiroj t’ua lehtësoj situatën nxënësve që nëpërmjet të pyetjeve të mësojnë më shumë”, shpjegon Gazmendi.

Nga sektori joqeveritar e ka, mirëpo e kërkon edhe mbështetjen nga institucionet për mundin e tij. Realizimi i ideve të tilla, mund t’ua lehtësojë mësimin nxënësve të shkollave fillore sikur Aldini. Për atë, dita shkollore mbaroi. Së bashku me babin e tij e lan Shkupin dhe tani kthehen në Tetovë. “Kur përgatitemi për të shkuar në shkollë nga Tetova, prap hyjmë në makinë dhe nisemi për në Shkup”, tregon Aldini deri sa vozitet në makinë.

Tre herë në javë, Aldini shkon në qendrën ditore për fëmijë me nevoja të posaçme. Sektori joqeveritar siguroi mjete për hapje të katër qendrave, në kuadër të shkollave të rregullta, në Manastir, Veles, Shtip dhe në Tetovë.

“Këtu bëj masazh, bisedoj me arsimtarin Boletin, ai ka llupë, mund të vizatoj... Ka edhe printer, vendoj letër ndërsa i e bën me alfabetin e Brajtit”, përshkruan Aldini, i lumtur që ka aktivitete të tilla pas shkollës. Këtë herë, fëmijët tjerë nuk kishin ardhur. Ai e kishte tërë vëmendjen e edukatorit vetëm për vete. Pas kryerjes së detyrave të shtëpisë erdhi koha për aktivitetin e tij të preferuar. Ai shtrihet në dyshek i cili bën vibracione të cilët i ndihmojnë të relaksohet. Për dallim prej tij, me siguri fëmijët tjerë të verbër, nuk kanë qasje deri në qendrat e tilla. Në fakt, shumica prej tyre, nuk kanë kushte moderne.

“Nuk është diçka e re nëse them se ka shumë familje të cilët në periudhën e kaluar janë shpërngulur nga Maqedonia, familje të pasura, sepse nuk i kishin shërbimet nga shkollat dhe institucionet që ju nevojiten fëmijëve të tyre me nevoja të posaçme”, deklaroi Shpëtim Latifi, menaxher i projektit të USAID-it.

Financimi i qendrave të këtilla ditore do të mbarojë për tre vjet. Ato shpresojnë se shteti do ta vazhdojë punën e tyre.

Erdhi koha për Aldinin dhe babin e tij të shkojnë në shtëpi. Dita e vështirë për to mbaroi.

“Kur do të rritem dua të bëhem artist. Shumë më pëlqen ajo temë”, thotë Aldini.

Babai i tij, shtoi se në Maqedoni nuk ka punësime për personat e verbër dhe se Aldini nuk do të mbetë këtu, arsimin e tij do ta vazhdojë jashtë shtetit.